 - Çdo veprimtari të nevojshme për zhvillimin teknologjik të industrisë mekanike, kimike, petrokimike, biokimike, farmaceutike, të energjisë bërthamore, termoelektrike dhe të energji alternative të rinovueshme, të industrisë nxjerrëse, përpunuese dhe prodhuese të qymyrit, hekurit, çelikut, metaleve dhe mineraleve jo hekur, të industrisë elektrike dhe elektronike, të industrisë ushqimore, bujqësore, blegtorale, peshkimit dhe të teknologjisë së informacionit.
 - Inxhinierizimin e proceseve industriale me furnizimin e sistemeve *hardware* dhe *software*.
 - Organizimin dhe drejtimin, për llogari të vet ose të të tretëve, së bashku me ofrimin e shërbimeve përkatëse të asistencës dhe konsulencës tekniko-tregtare, të proceseve industriale,

Faqe 2 / 10

/firma, vulë/

Unë, ROVENA VYSHKA, përkthyes zyrtarë e gjuhës ITALIANE, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 406, datë 31.07.2024, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit ITALIANE në gjuhën e synuar SHQIPE me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.

Data: 14.07.2026

DHOMA E TREGTISË E MARCHE

Prot: CEW/740/2026/CAP0105

30/6/2026

Kjo certifikatë duhet të printohet ekskluzivisht në kopje unike me numrin e protokollit CEW/740/2026/CAP0105. Kopjet eventuale duhet të kenë numra të tjerë protokoll.

të veprave dhe impianteve të çdo lloji dhe destinacioni në sektorin industrial, të transporteve tokësore, detare dhe ajrore, të ndërtimit, tregtisë dhe të infrastrukturave civile, shëndetësore, portuale, rrugore, hekurudhore dhe aeroportuale.

- Zhvillimin e proceseve industriale të transformimit në përgjithësi dhe të proceseve të trajtimit të mbetjeve, duke përfshirë ushtrimin e veprimtarive përkatëse dhe të nevojshme të projektimit, realizimit, riparimit, transformimit, përmirësimit, zgjerimit, vënies në funksion, testimit dhe administrimit.

- Hartimin dhe zbatimin e veprimtarive të kërkimit dhe eksperimentimit, me zhvillimin e materialeve të avancuara dhe/ose pajisjeve inovative, si dhe përhapjen e rezultateve në sektorët përkatës të prodhimit, edhe nëpërmjet veprimtarive të formimit profesional.

- Analizat, identifikimin dhe zbatimin e zgjidhjeve teknologjike që synojnë përdorimin racional të burimeve të energjisë, rritjen e efikasitetit energjetik dhe kursimin e energjisë.

- Kryerjen, edhe në bashkëpunim dhe në kooperim me subjekte të tjera publike dhe private, të studimeve, kërkimeve, veprimtarive të inovacionit teknologjik dhe programeve apo ndërhyrjeve të tjera të ndryshme, duke marrë përsipër edhe administrimin përkatës të tyre, me qëllim njohjen, vlerësimin dhe përdorimin e drejtë të teknikave dhe teknologjive në sektorët përkatës të prodhimit.

- Furnizimin me makineri dhe shërbime për kontrollin e proceseve të punës, të mirëmbajtjes, të sigurisë në punë, të optimizimit të konsumit të energjisë dhe të kontrollit të cilësisë në veprimtaritë civile, të sektorit të shërbimeve dhe industriale.

- Furnizimin me sisteme informatike *hardware* dhe *software*, si dhe me metoda për monitorimin e territorit.

- Kryerjen e veprimtarive të mbështetjes në fushën e prokurimeve publike, ndërtimit dhe veprave ndërtimore në përgjithësi, të certifikimeve SOA dhe të certifikimeve të cilësisë mjedisore.

- Kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjes për zhvillimin e modeleve dhe proceseve të *Building Information Modeling* (BIM) dhe, në përgjithësi, në fushën e digjitalizimit të sektorit të ndërtimit.

- Veprimtaritë e kërkimit, studimit, llogaritjeve, konsulencës, menaxhimit të projekteve, financimit të projekteve, studimeve të fizibilitetit teknik dhe ekonomiko-financiar, konsulencës strategjike, patentave dhe pronësisë industriale, si dhe asistencë teknike për vepra, impiante dhe vendosje civile e industriale në sektorët përkatës të prodhimit, edhe në fushën e cilësisë së ndërmarrjes dhe të sigurisë e higjienës në punë dhe në mjediset e punës.

- Asistencën dhe mbështetjen në projektimin e sistemeve informatike që shërbejnë për mbështetjen e veprimtarive teknike dhe menaxheriale, përfshirë zhvillimin e programeve aplikative.

- Marrjen e përfaqësive tregtare nga prodhues kombëtarë ose ndërkombëtarë që veprojnë në të gjithë sektorët, përfshirë edhe sektorin ushqimor.

- Nxitjen e zhvillimit ekonomik të ndërmarrjeve italiane jashtë vendit dhe ofrimin e asistencës në marrëdhëniet me institucionet dhe ndërmarrjet në shtete të huaja, duke përfshirë promovimin e tregtisë së jashtme.

/firma, vula/

Unë, ROVENA VYSHKA, përkthyes zyrtar e gjuhës ITALIANE, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 406, datë 31.07.2024, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit ITALIANE në gjuhën SHQIPE me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.
Data: 14.07.2026



DHOMA E TREGTISË E MARCHE

Prot: CEW/740/2026/CAP0105

30/6/2026

Kjo certifikatë duhet të printohet ekskluzivisht në kopje unike me numrin e protokollit CEW/740/2026/CAP0105. Kopjet eventuale duhet të kenë numra të tjerë protokollit.

- Organizimin, promovimin dhe komercializimin, edhe për llogari të të tretëve, të kongreseve, pritjeve, ekspozitave, panairove, koncerteve, ceremonive dhe veprimtarive të ngjashme, që zhvillohen në ambiente të paluajtshme në pronësi të shoqërisë dhe/ose të të tretëve.
 - Tregtinë me shumicë dhe pakicë, importin dhe eksportin e çdo lloj produkti, përfshirë edhe produktet ushqimore.
 - Veprimtaritë e kërkimit të tregut, marketingut dhe ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri koncesionare e reklamave, si dhe marrjen e përfaqësive, koncesioneve dhe marrëdhënieve të agjencisë, me ose pa depozitë, si në Itali ashtu edhe jashtë saj; grumbullimin e reklamave për gazeta ditore, revista, periodikë, faqe interneti dhe televizione; administrimin e hapësirave reklamuese në çdo lloj platforme mbështetjeje.
 - Ofrimin e konsulencës për organizata jofitimprurëse, ndërmarrje dhe administrata publike në fushat e ndërkombëtarizimit të ndërmarrjeve, krijimit të ndërmarrjeve të reja, menaxhimit të eksporteve, formimit profesional për punësim dhe zhvillimit të ndërmarrjeve; si dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve që lidhen me temat e sipërpërmendura.
 - Projektimin, konceptimin dhe realizimin e fushatave të *fundraising* (mbledhjes së fondeve).
 - Konceptimin dhe realizimin e logove dhe fushatave të imazhit.
 - Projektimin, realizimin dhe komercializimin e kurseve profesionale.
 - Ofrimin e shërbimeve dhe konsulencës për produkte *web*, multimediale dhe të *e-commerce* (tregtisë elektronike).
 - Ushtrimin e veprimtarisë botuese, informative dhe kulturore, me qëllim prodhimin, redaktimin, shtypjen, publikimin dhe shpërndarjen e buletineve, periodikëve, vjetarëve, revistave dhe botimeve në përgjithësi, edhe në internet, si dhe të dokumentacionit audio-viziv me karakter teknik-profesional dhe shkencor, në çdo lloj platforme mbështetjeje.
- Shërbimet profesionale do të kryhen dhe do të nënshkruhen nga profesionistë të regjistruar rregullisht në urdhrat ose regjistrat profesionalë përkatës, secili brenda kompetencave të veta, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Për ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve, shoqëria mund të përdorë shërbimet e ortakëve, të profesionistëve të tjerë të jashtëm ose të ekspertëve, të njohur dhe të pranuar nga porositësi, gjithmonë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Në mënyrë jo mbizotëruese, shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha veprimet mbi pasuritë e luajtshme, pasuritë e paluajtshme, veprimtaritë tregtare dhe financiare që konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë, duke përjashtuar shprehimisht veprimtaritë që janë të rezervuara për profesionistët e regjistruar në regjistrat profesionalë përkatës.
- Shoqëria mund gjithashtu të marrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, interesa ose pjesëmarrje në ndërmarrje apo shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të sajën; si dhe t'u japë të tretëve fidejusione dhe garanci reale ose personale në përgjithësi, gjithmonë brenda kufijve të parashikuar nga ligji dhe në përputhje me Tekstin Unik për Çështjet Bankare dhe të Kreditit në lidhje me ushtrimin e veprimtarive financiare të ndaluara, dhe duke përjashtuar çdo veprimtari të parashikuar nga Dekretet Legjislative nr. 415/1996 dhe nr. 58/1998.

Sistemi i Administrimit dhe Kontrollit

Faqe 4 / 10

/firma, vula/

Unë, ROVENA VYSHKA, përkthyesë zyrtare e gjuhës ITALIANE, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 406, datë 31.07.2024, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit ITALIANE në gjuhën shqipe me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.

Data: 14.07.2026



DHOMA E TREGTISË E MARCHE

Prot: CEW/740/2026/CAP0105

30/6/2026

Kjo certifikatë duhet të printohet ekskluzivisht në kopje unike me numrin e protokollit CEW/740/2026/CAP0105. Kopjet eventuale duhet të kenë numra të tjerë protokollit.

Sistemi i Administrimit i miratuar: Administrator i Vetëm

- Administrator i Vetëm

Numri i anëtarëve në detyrë: 1

Kohëzgjatja në detyrë: Me kohë të pacaktuar

Nga data 01/04/2022

Informacione mbi Statutin

Kompetencat Statutore:

Organi administrativ, në përputhje me strukturën e përcaktuar nga ortakët në momentin e emërimit, pajiset me kompetencat më të gjera për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet që i konsideron të përshtatshme ose të dobishme për arritjen e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, përveç atyre që ligji ose akti i themelimit ua rezervojnë ekskluzivisht vendimeve të ortakëve.

Kufizimet e mundshme të kompetencave administruese i nënshtrohen vendimmarrjes së ortakëve.

Organi administrativ mund të emërojë drejtorë, drejtues me kompetenca të përgjithshme ose përfaqësues për kryerjen e veprimeve të caktuara ose kategorive të caktuara të veprimeve, duke përcaktuar kompetencat e tyre.

Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i takon Administratorit të Vetëm.

Në rast të emërimit të Këshillit të Administrimit, përfaqësimi i shoqërisë i takon Kryetarit të Këshillit të Administrimit, Nënkryetarit në rast mungese ose pamundësie të Kryetarit, dhe administratorëve të deleguar individualë, nëse janë emëruar, brenda kufijve të delegimeve të dhëna.

Në rast të emërimit të disa administratorëve, përfaqësimi i shoqërisë u takon atyre së bashku ose veçmas, ose me nënshkrim të veçantë për administrimin e zakonshëm dhe me nënshkrim të përbashkët për administrimin e jashtëzakonshëm, në të njëjtën mënyrë siç u janë dhënë kompetencat administruese në momentin e emërimit.

Shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve ndërmjet ortakëve

Neni 19 i Statutit të Shoqërisë

Klauzolat e tërheqjes:

Informacion që gjendet në Statut / Akt Themelimi

Klauzolat e së drejtës së parablerjes:

Informacion që gjendet në Statut / Akt Themelimi

Klauzolat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve:

Informacion që gjendet në Statut / Akt Themelimi

Faqe 5 / 10

/firma, vula/

Unë, ROVENA VYSHKA, përkthyesë zyrtare e gjuhës ITALIANE, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 406, datë 31.07.2024, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit ITALIANE në gjuhën e synuar SHQIPË me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.
Data: 14.07.2026



DHOMA E TREGTISË E MARCHE

Prot: CEW/740/2026/CAP0105

30/6/2026

Kjo certifikatë duhet të printohet ekskluzivisht në kopje unike me numrin e protokollit CEW/740/2026/CAP0105. Kopjet eventuale duhet të kenë numra të tjerë protokolli.

Informacione në lidhje me Asetet dhe Informacione Financiare

Kapitali i shoqërisë në EURO:

I miratuar 10,000.00

I nënshkruar 10,000.00

I derdhur 10,000.00

Kontributet në PARA

Kontributet dhe përfitimet:

Informacion që gjendet në Statut / Akt Themelimi

Instrumentet financiare të parashikuara nga statuti:

- Titujt e borxhit

Neni 20 i Statutit të Shoqërisë

Veprimtaria

Veprimtaria kryesore e ushtruar nga shoqëria:

Shërbime të projektimit të inxhinierisë së integruar

Data e fillimit të veprimtarisë të shoqërisë: 29/09/2021

Veprimtaria e zhvilluar në selinë ligjore:

Shërbime të projektimit të inxhinierisë së integruar

Veprimtaria dytësore e zhvilluar në selinë ligjore:

Veprimtari të tjera të konsulencës sipërmarrëse dhe konsulencë tjetër administrativo-menaxheriale dhe planifikim biznesi.

Informacion shtesë mbi ndërmjetësimin

Veprimtari si ndërmjetës biznesi.

Titullarë të funksioneve ose kualifikimeve

* UMBERTO ALESI (përfaqësues i shoqërisë)

i lindur në Ascoli Piceno (AP) më 02/07/1966

kodi fiskal: LSAMRT66L02A462I

- PËRGJEGJËS TEKNIK data e aktit të emërimit 29/09/2021

Mandati në detyrë: Deri në revokim

- PËRFAQËSUES data e aktit të emërimit 08/03/2023

/firma, vula/

Unë, ROVENA VYSHKA, përkthyes zyrtarë e gjuhës ITALIANE, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 406, datë 31.07.2024, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit ITALIANE në gjuhën e synuar SHQIPË me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.
Data: 14.07.2026

DHOMA E TREGTISË E MARCHE

Prot: CEW/740/2026/CAP0105

30/6/2026

Kjo certifikatë duhet të printohet ekskluzivisht në kopje unike me numrin e protokollit CEW/740/2026/CAP0105. Kopjet eventuale duhet të kenë numra të tjerë protokolli.

Prezantimi më 09/03/2023

Mandati në detyrë: Deri në revokim

Data e regjistrimit: 13/03/2023

Kompetencat:

Me akt të noterit Aleandro Allevi të Ascoli Piceno, me nr. repertori 5494, datë 8 mars 2023, është emëruar përfaqësues i shoqërisë Z. Umberto Alesi, me kompetencën për të kryer veprimtaritë e mëposhtme:

- të blejë dhe të shesë mallra, lëndë të para, shërbime dhe pasuri të luajtshme në përgjithësi, në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë;
- të lidhë kontrata punimesh;
- të lidhë kontrata komisioni, transporti, agjencie, ndërmjetësimi dhe kontrata sipërmarrjeje, përfshirë ato që lidhen me shërbime profesionale me ente publike dhe private;
- të lidhë kontrata depozitimi, përfshirë në magazina të përgjithshme; të nënshkruajë dhe të transferojë, edhe me anë të transfertave, fletë-depozitimi dhe fletë-pengu.
- të lidhë kontrata bankare për hapje kredie, paradhënie dhe skonto;
- të lidhë kontrata për llogari rrjedhëse;
- të hapë llogari rrjedhëse bankare dhe postare, të lëshojë çeqe mbi to, edhe me tejkallim të gjendjes, brenda kufijve të kredive të akorduara;
- të kërkojë financime; të kryejë tërheqje nga librezat e kursimit, qofshin ato nominale ose të lidhura me kushte;
- të hapë kasetë sigurie dhe të tërheqë përmbajtjen e tyre;
- të lidhë kontrata financimi dhe huaje pa garanci reale;
- të lidhë kontrata qiraje operative dhe/ose financiare (leasing);
- të lidhë kontrata furnizimi;
- të lidhë kontrata qiraje dhe dhënieje me qira, përfshirë edhe ato me afat mbi nëntë vjet, si dhe kontrata nën-qiraje;
- të transferojë të drejtat kontraktuale, të arkëtojë paraprakisht dhe të transferojë qiratë;
- të lidhë kontrata punimesh;
- të krijojë shoqëri dhe të marrë pjesë në to;
- të lidhë kontrata pjesëmarrjeje;
- të lidhë kontrata transporti;
- të japë dhe të pranojë mandate të posaçme, t'i revokojë ose të heqë dorë prej tyre, si dhe të kërkojë llogaridhënie;
- të lidhë kontrata komisioni, transporti, agjencie, ndërmjetësimi dhe sipërmarrjeje;
- të lidhë kontrata depozitimi, edhe në magazina të përgjithshme; të nënshkruajë dhe të transferojë, edhe me anë të transfertave, fletë-depozitimi dhe fletë-pengu;
- të japë me qira dhe në huapërdorje pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;

Faqe 7 / 10

/firma, vula/

Unë, ROVENA VYSHKA, përkthyesë zyrtare e gjuhës ITALIANE, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 406, datë 31.07.2024, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit ITALIANE në gjuhën e synuar SHQIPTAR me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.
Data: 14.07.2026



DHOMA E TREGTISË E MARCHE

Prot: CEW/740/2026/CAP0105

30/6/2026

Kjo certifikatë duhet të printohet ekskluzivisht në kopje unike me numrin e protokollit CEW/740/2026/CAP0105. Kopjet eventuale duhet të kenë numra të tjerë protokollit.

- të lidhë kontrata rrjeti, marrëveshje të përkohshme ndërmarrjesh, rrjete të përkohshme ndërmarrjesh dhe konsorciume;
- të lidhë kontrata për transferimin e kredive, të çdo vlere, që shoqëria ka ndaj kujtqdo, përfshirë administratën publike, entet publike dhe subjektet private;
- të lidhë kontrata sigurimi kundër dëmeve dhe për sigurimin e jetës; të negociojë dhe të pranojë primet dhe dëmshpërblimet;
- të kryejë transaksione dhe t'i kundërshtojë ato;
- të japë dhe të pranojë mandate kredie;
- t'u transferojë pasuri kreditorëve;
- të kërkojë dhe të marrë, në këmbim të mandateve, kapitale, interesa, shuma, vlera, shuma të çeqeve, kuponë, mandate, çeqe, çdo dokument tjetër kredie nga persona privatë, banka, persona juridikë ose administrata publike, nga zyrat postare, telegrafike dhe hekurudhore;
- të tërheqë nga zyrat postare, hekurudhore, të transportit detar ose ajror, apo nga çdo zyrë tjetër, pako, letra, sende me vlerë të siguruara, mallra dhe çdo objekt tjetër; të tërheqë tituj të pagueshëm ndaj mbajtësit ose nominalë nga privatë, institute krediti, persona juridikë dhe administrata publike;
- të kryejë çdo veprim pranë zyrave të borxhit publik, arkës së depozitave dhe huave, thesarit provincial, doganave, drejtorisë rajonale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- të lëshojë urdhërpagesa; të lëshojë kambiale, t'i pranojë ose refuzojë ato; t'i transferojë, t'i kërkojë dhe t'i arkëtojë; t'i kundërshtojë; të iniciojë veprime kambiare; të lëshojë ose të pranojë urdhërpagesa në mallra;
- të ratifikojë veprimtarinë e administratorit të biznesit;
- të ushtrojë çdo veprim juridik dhe të paraqesë çdo kundërshtim për fakte të paligjshme;
- të kërkojë kompensimin e dëmeve;
- të kërkojë, të pajtohet dhe të arkëtojë dëmshpërblime për dëme që rrjedhin nga lufta, fatkeqësi publike, shpronësime dhe zënie të përkohshme;
- të kërkojë regjistrime dhe shënime hipotekore;
- të kryejë regjistrime dhe shënime në çdo regjistër tjetër publik;
- të iniciojë procedura shpronësimi dhe ekzekutime të detyrueshme.
- të heqë dorë nga parashkrimet e fituara;
- të paraqesë deklaratë falimentimi, të përfaqësojë shoqërinë që do të themelohet në procedurat gjyqësore përkatëse dhe të pohojë ekzistencën e kredive;
- të pranojë marrëveshje ose t'i kundërshtojë ato;
- të përfaqësojë shoqërinë që do të themelohet përpara çdo autoriteti administrativ, sindikal dhe politik;
- të përfaqësojë shoqërinë që do të themelohet në gjykim, si paditëse ashtu edhe e paditur, në çdo shkallë juridiksioni, përfshirë komisionet tatimore dhe gjykatat e posaçme

Faqe 8 / 10

/firma, vula/

Unë, ROVENA VYSHKA, përkthyesë zyrtare e gjuhës ITALIANE, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 406, datë 31.07.2024, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit ITALIANE në gjuhën e synuar SHQIPE me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.
Data: 14.07.2026

DHOMA E TREGTISË E MARCHE

Prot: CEW/740/2026/CAP0105

30/6/2026

Kjo certifikatë duhet të printohet ekskluzivisht në kopje unike me numrin e protokollit CEW/740/2026/CAP0105. Kopjet eventuale duhet të kenë numra të tjerë protokolli.

- administrative dhe të punës; të emërojë dhe të revokojë avokatë, përfaqësues gjyqësorë dhe ekspertë; të kërkojë vendosjen ose heqjen e vulave; të paraqesë kundërshtime; të kryejë inventarizime;
- të kryejë çdo procedurë tatimore, të nënshkruajë dhe të paraqesë ankime, kallëzime, pretendime, marrëveshje dhe kërkesa për verifikime tatimore;
 - të kërkojë amnisti ose lehtësime fiskale, të paraqesë kërkesa për aderim dhe të procedojë me pajtim gjyqësor për mosmarrëveshjet tatimore;
 - të kërkojë dhe të marrë shtyrje të pagesës së tatimeve, të lidhë aktet përkatëse, të japë garanci, përfshirë edhe garanci hipotekore;
 - të kryejë dhe të angazhohet në arbitrazh, edhe si arbitrazh me mirëkuptim;
 - të blejë, të japë me qira dhe të shesë pasuri të luajtshme të çdo lloji, përfshirë ato të regjistruara në regjistrat publikë;
 - të blejë pasuri të paluajtshme, t'i shesë dhe t'i ngarkojë me hipotekë, të depozitojë rregullore bashkëpronësi, duke ndërhyrë për këtë qëllim edhe në rastet e parashikuara nga neni 2204 i Kodit Civil;
 - të lidhë kontrata pune të çdo lloji, duke kryer të gjitha procedurat dhe formalitetet e nevojshme ose të përshtatshme;
 - të punësojë dhe të largojë personel në varësi, duke kryer të gjitha procedurat dhe formalitetet e nevojshme ose të përshtatshme.

* DANIELE ALESI (përfaqësues i shoqërisë)

i lindur në Ascoli Piceno (AP) më 12/11/1983

kodi fiskal: LSADNL83S12A462N

- ADMINISTRATOR I VETËM data e aktit të emërimit 01/04/2022

Mandati në detyrë: Me afat të pacaktuar

Data e regjistrimit: 15/04/2022

Selitë Dytësore dhe Njësitë Vendore

Njësi vendore

Zyrë

Ascoli Piceno (AP), Via Fonte di Campo, nr. 117, CAP 63100

Veprimtaria e ushtruar:

Shërbime të projektimit të inxhinierisë së integruar (nga data 31/05/2022).

Veprimtaria dytësore e ushtruar:

Veprimtari të tjera të konsulencës sipërmarrëse dhe konsulencë tjetër administrativo-menaxheriale dhe planifikim biznesi (nga data 31/05/2022).

Data e hapjes: 31/05/2022

Faqe 9 / 10

/firma, vula/

Unë, ROVENA VYSHKA, përkthyes zyrtarë e gjuhës ITALIANE, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 406, datë 31.07.2024, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit ITALIANE në gjuhën e synuar SHQIPJE me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.
Data: 14.07.2026

DHOMA E TREGTISË E MARCHE

Prot: CEW/740/2026/CAP0105

30/6/2026

Kjo certifikatë duhet të printohet ekskluzivisht në kopje unike me numrin e protokollit CEW/740/2026/CAP0105. Kopjet eventuale duhet të kenë numra të tjerë protokolli.

Njësi vendore Zyrë
San Benedetto del Tronto (AP), Via Gabriele D'Annunzio, nr. 36, CAP 63074

Veprimtaria e ushtruar:

(Nga data 19/02/2026) Menaxhimi i projekteve që lidhen me vepra të inxhinierisë së integruar, i ushtruar në formën e shoqërisë (shoqëri inxhinierike).

Data e hapjes: 19/02/2026

Kjo certifikatë pasqyron informacionet/të dhënat e regjistruara në Regjistrin në datën e sotme.

Kjo certifikatë nuk mund t'u paraqitet organeve të administratës publike apo administratorëve privatë të shërbimeve publike.

Arkivuesi i Regjistrit të Shoqërive
Barbara Cavalli

Paguar për tarifë 5.00 euro
Totali 5.00 euro

Deklarohet gjithashtu se, për subjektin e regjistruar me të dhënat identifikuese të mësipërme, nuk rezulton e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive asnjë deklaratë për procedurë të falimentimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Deklarohet gjithashtu se, për subjektin e regjistruar me të dhënat identifikuese të mësipërme, nuk rezulton e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive asnjë procedurë falimentimi në zhvillim, sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo certifikatë lëshohet e përjashtuar nga taksa e pullës, në përputhje me D.P.R. nr. 601, datë 29/09/1973, nenet 15 dhe 16 për operacionet e kreditimit. Çdo përdorim i saj për qëllime të ndryshme mbetet nën përgjegjësinë personale të përdoruesit.

Lëshuar nëpërmjet sistemit elektronik të automatizuar pranë Zyrës së Regjistrit të Shoqërive të Ascoli Piceno, në përputhje me nenin 3 të Dekretit Legjislativ nr. 39/93.

Për Arkivuesin
Deborah Giraldi
Funksionari i deleguar
Piergiorgio Magnoni /firma, vula/

*** fundi i certifikatës ***

Faqe 10 / 10

/firma, vula/

Unë, ROVENA VYSHKA, përkthyes zyrtar e gjuhës ITALIANE, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate 406, datë 31.07.2024, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit ITALIANE në gjuhën e synuar SHQIPE me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.
Data: 14.07.2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MANUSHAQE H. JAUPI**

**DATE 14/07/2026
NR REP 6157**



V2026051340499862347



VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 14/07/2026, para meje Notere MANUSHAQE H. JAUPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.2, GEORGE W. BUSH, NR.13, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Rovena Vyshka, atësia Edmond, amësia Efeli, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Xhezmi Delli; Nd. 17; H. 2; Ap. 25; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 13/09/1978, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 039691172 dhe nr. personal H85913095H, .

Përkthyesja është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, ie cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur "*Certifikate regjistrimi ne seksionin e zakonshem*" , nga gjuha Italisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroi se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

MANUSHAQE H. JAUPI

